



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
KËSHILLI TEKNIK

Nr. 230 Prot.

Tiranë, më datë 08.05.2026

VENDIM
Nr. 50, datë 08.05.2026

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, si dhe në Vendimin e KKTKM-së, Nr. 75 datë 19.02.2020 “Për miratimin e llojeve të ndërhyrjeve me karakter mirëmbajtës të pasurive kulturore, sipas listës bashkëlidhur”, i ndryshuar, pas shqyrtimit të projektit, në mbledhjen e datës 08.05.2026, Këshilli Teknik:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Vendosje grilash të jashtme në katin e tretë në godinën II-053 - Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit - rruga “Abdi Toptani”, sot Kontrolli i Lartë i Shtetit”, Monument Kulture i Kategorisë së II-të, me aplikues Z. Fatjon Saliu dhe zhvillues **Kontrolli i Lartë i Shtetit**;
2. Gjatë procesit të zbatimit punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1 dhe 2;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
5. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

